



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 453 Prot.

Tiranë, më 02.07 2015

VENDIM Nr. 72 datë 23.06.2015

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 41 dhe 43, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.9, të datës 23.06.2015, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim* në kuadër të Shkollës së doktoraturës "Metodologjitë dhe praktikat e kërkimeve në fushën e prehistorisë" miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, drejtues Prof. Ilir Gjipali (IA),

VENDOSI:

- I. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim* në kuadër të Shkollës së doktoraturës "Metodologjitë dhe praktikat e kërkimeve në fushën e prehistorisë" paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, drejtues Prof. Ilir Gjipali (IA), në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
 - Ekspeditë sërveje në zonën e Vlorës dhe në rrethin e Librazhdit.
 - Sondazh në dy vendgjetje prehistorike në Treport dhe në fshatin Qukës Shkumbin të Librazhdit. Sondazhet do të kryhen nga studentët e doktoraturës në fushën e prehistorisë nën mbikëqyrjen e arkeologut I. Gjipali.
- II. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2015.
- III. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: www.asha.gov.al